



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr 396 / Prot. 18

Divjakë më 16 / 01 / 2025

Lënda:

THIRRJE

“PËR ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SË RADHËS TË KËSHILLIT BASHKIAK
DIVJAKË, MUAJI JANAR 2025 ”

ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË DIVJAKË
PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, neni 56, pika 2, gërma (a) të Ligjit nr 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Divjakë, miratuar me VKB, nr 28 datë 13.04.2020, ndryshuar me V.K.B. Nr.48 datë 25.09.2023, neni 56, Ju njoftojmë se: Më datë: 24. 01. 2025, ditën e Premte ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve, pranë Shtëpisë së Kulturës Divjakë, në katin e dytë thirret “Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin Janar 2025”. **Me këtë Rend dite:**

1. Miratim i Rendit të Ditës.
 2. Miratim i Proçesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më datë 30.12.2024.
 3. Informacion mbi zbatimin e Vendimeve të Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin Dhjetor 2024.
 4. **Projekt-vendim:** Për miratimin e Kriteve për familjet në nevojë që do trajtohen me ndihmë ekonomike nga Fondi i Kushtëzuar deri në 6% “ Për bllok ndihmën “ për vitin 2025.
 5. **Projekt-vendim:** Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondit i kushtëzuar deri 6% për muajin Dhjetor 2024.
 6. **Projekt-vendim:** Për rimbursimin e invalidëve për 1 (një) vit sipas ligjit nr 8303, datë 18.03.1998 “Për transportin rrugor “ i ndryshuar.
 7. **Projekt-vendim:** Për rinovimin e “Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërvendor, për menaxhimin e landfillit(peshimin, depozitimin dhe mirëmbajtjen e rrugës hyrëse) në Impiantin e mbetjeve urbane, të Qarkut Fier”
 8. **Projekt-vendim:** Për miratimin e një rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2025.
 9. **Projekt-vendim:** Për miratimin e një ndryshimi në VKB Nr.65 datë 24.12.2024” Mbi miratimin e PBA 2025-2027, Buxhetit të vitit 2025, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Divjakë.
 10. **Projekt-vendim:** Për miratimin e raportit të vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave në Bashkinë Divjakë për vitin 2026-2028.
- Mbledhja e Komisioneve:**-Për pikat Nr: 4,5,6,7,8,9,10 : Komisioni i Ekonomisë dhe i Financave.
- Duke ju falenderuar !**

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ana Nako

